



**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri**

**FJALIMI I KRYETARIT TË PREZENCËS, AMBASADORIT EUGEN WOLLFARTH,
NË TRYEZËN PËR ZGJEDHJET DHE ADMINISTRIMIN ZGJEDHOR**

27 tetor 2010

Ambasador Nesho,
Të nderuar pjesëmarrës,
zonja dhe zotërinj,
mirëmëngjesi!

Më lejoni t'ju them, para së gjithash, sa i gëzuar jam që gjendem këtu me ju për të diskutuar një temë që është me rëndësi të konsiderueshme politike në këtë kohë.

Kur flitet për "*zgjedhjet dhe sfidat e reformës zgjedhore në Shqipëri*", hollësitat e çdo reforme duhet të diskutohen, miratohen dhe së fundmi të zbatohen nga shqiptarët dhe vetëm nga shqiptarët.

Thënë kjo, jam i sigurt se asnjë nuk do të kundërshtojë, nëse miqtë e këtij vendi, aq më tepër ata që kanë një mandat specifik për zgjedhjet dhe reformën zgjedhore, japin disa mendime për aspektet më të përgjithshme të procesit.

Pikë së pari, mendoj se është e rëndësishme për të vënë në pah dhe për të pranuar se Kodi Zgjedhor ekzistues, i miratuar në vitin 2008, solli disa përmirësime shumë të rëndësishme.

Në fakt, Raporti Përfundimtar i OSBE/ODIHR-it i 2009-ës tha se shumica e angazhimeve të OSBE-së u përmbushën.

Megjithatë, si tashmë e dimë, Raporti gjithashtu thotë me të njëjtën qartësi se: "Edhe pse përmbushën shumicën e angazhimeve ndaj OSBE-së, këto zgjedhje nuk realizuan plotësisht potencialin e Shqipërisë për t'iu përmbajtur standardeve më të larta për zgjedhje demokratike".

Pra, është e qartë se një reformë zgjedhore e mëtejshme është e nevojshme.

Dhe ne duhet të besojmë se të njëjtin këndvështrim ka edhe klasa politike shqiptare, duke pasur parasysh pjesëmarrjen e gjerë të saj në tryezën e rrumbullakët të së premtes së kaluar.

Pra, mund të biem dakord që reforma është e rëndësishme.

Ajo çka duhet të vendosim është se çfarë lloj reforme nevojitet tani.

E thënë thjesht, dhe pa dëshiruar ta shtjelloj më tej këtë pikë, tani që data 8 maj 2011 është ngulitur në mendjet tona, do të argumentoja që diskutimi për reformën zgjedhore mund të duhet të ndahet në dy kapituj të veçantë:

i) Gjysma e parë të zhvillohej tani, në lidhje me zgjedhjet e qeverisjes vendore;

ii) Gjysma e dytë për reformën e zgjedhjeve parlamentare të zhvillohej menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve të qeverisjes vendore.

A ekziston rreziku që një diskutim për reformën zgjedhore mund të përfundojë duke i përzier të dyja çështjet?

Po, mendoj që ndoshta ekziston.

Gjithë çka mund të marr me mend është që klasa politike është gjithashtu në dijeni të kësaj gracke dhe do të gjejë mënyra të përshtatshme për të mos rënë në të.

Jam i bindur se aktivitetet publike, si ky që ne jemi këtë mëngjes, janë mundësi të përkryera për të ngritur gjithashtu shqetësime të tilla, në mënyrë të veçantë kur konsiderojmë që kemi midis nesh një kryetar dhe dy ish-kryetarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Nga secila pikëpamje, në funksion të çdo reforme zgjedhore, besoj se çdo proces duhet të konsultohet plotësisht në mënyrë të gjerë.

Çdo reformë duhet të kërkojë konsensusin më të gjerë politik të mundshëm, në mënyrë që çdo reformë e miratuar të mund ta kalojë "testin e kohës" dhe të mos hidhet ne kosh e tëra apo një pjesë a konsiderueshme e saj, siç ka qenë shpesh rasti në të kaluarën.

Duke pasur parasysh mandatin e Prezencës, nuk do të habiteni nëse më dëgjoni të them gjithashtu se çdo paketë e reformës duhet, sigurisht, të bazohet në parimet e shtetit të së drejtës dhe Kushtetutës së Shqipërisë.

Z. Kryetar, zonja dhe zotërinj, siç mund të dini, kur shfletoni Raportin përfundimtar të OSBE/ODIHR 2009, aty citohen 31 rekomandime.

Megjithëse besoj se do të ndiheni të lehtësuar të mësoni që nuk do të ndalem të komentoj për secilin rekomandim, dëshiroj të tërheq vëmendjen tuaj në lidhje me rekomandimin e parë mbi rolin e partive politike.

Ky është një rekomandim i rëndësishëm, thelbësor dhe kritik për çdo reformë të suksesshme, dhe më gjerësisht për zhvillimin me sukses të zgjedhjeve lokale në maj të vitit të ardhshëm.

Lejomëni të lexoj rekomandimin:

“Partitë politike duhet të tregojnë vullnet politik për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike konform privilegjeve të mëdha që gëzojnë sipas ligjit në lidhje me zhvillimin e zgjedhjeve.

Ato duhet të realizojnë detyrat e tyre zgjedhore në mënyrë të përgjegjshme në interesin e përgjithshëm të Shqipërisë.”

Po e theksoj dhe një herë: “Ato duhet të realizojnë detyrat e tyre zgjedhore në mënyrë të përgjegjshme në interesin e përgjithshëm të Shqipërisë.”

Ky është një paragraf detyrues, bindës dhe nuk ka nevojë për komente shpjeguese.

Z. Kryetar, zonja dhe zotërinj,

Të mos harrojmë që kanë mbetur vetëm 28 javë nga Dita e Zgjedhjeve në maj të vitit të ardhshëm dhe “Ora Zgjedhore”, le të themi, ka nisur tik-takun me një ritëm të shpejtë dhe alarmues.

Zgjedhjet për qeverisjen vendore do të zhvillohen dhe duhet të zhvillohen në mënyrë profesionale, ku të plotësohen të gjitha angazhimet ndaj OSBE-së dhe jo vetëm disa prej tyre.

Detyra e këtij vendi, në këndvështrimin tim, është që të kthejë faqen e historisë së zgjedhjeve problematike në Shqipëri, në mënyrë përfundimtare dhe të pakthyeshme.

Tani është koha që të gjitha partitë politike të vendosin në plan të parë interesin kombëtar dhe të përmbushin këtë detyrë të rëndësishme.

E premtja e kaluar ishte një fillim i mbarë.

Por është vetëm një fillim.

Koha po ecën, zgjedhjet po afrohen dhe nuk ka kohë për të humbur.

Faleminderit!